

GJYKATA E APELIT

PN1 Nr. 2002/17

Numri i rastit: PAKR 1/2017

(Pkr nr. 218/14 Gjykata themelore Prishtinë)

Data: 26 tetor 2017

Gjyqtarja kryesuese dhe raportuese në rastin PAKR 1/2017, gjyqtarja Elka Filcheva-Ermenkova, me ndihmën e zyrtares ligjore të EULEX-it Kerry Moyes duke vepruar si procesmbajtëse ;

Në rastin kundër të pandehurit :

E.S., nga babai xxx, i lindur më xxx në xxx, në paraburgim që nga arrestimi i tij me datën xxx deri me datën xxx, në arrest shtëpiak prej datës xxx deri me xxx kur iu caktua serish paraburgimi;

I ngarkuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Speciale PPS nr. 467/2009 të datës 24 prill 2014, të ndryshuar me datën 27 prill 2016 me:

Pika 1: Shtytje për kryerjen e vrasjes së rëndë në kundërshtim me nenin 24 dhe 147 (3) dhe (9) të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPK);

Pika 2: Detyrim në kundërshtim me nenin 267 (1) dhe (2) të KPPK-së dhe

Pika 3: Dhunim në kundërshtim me nenin 193 (1) dhe (2) KPPK-së;

i shpallur fajtor sipas Aktgjykimit të Gjykatës themelore të Prishtinës Pkr. nr. 218/14 të datës 17 maj 2016 për Pikën një: vepra penale e **Shtytjes për kryerjen e vrasjes së rëndë** në kundërshtim me nenin 24 dhe 147 (3) dhe (9) të KPPK-së; dhe Pikën dy: Vepra penale e **Detyrimit** në kundërshtim me nenin 267 dhe i dënuar me dënimin unik me burgim afatgjatë prej 37 (tridhjetë e shtatë) vitesh; vepra penale **Dhunim** në kundërshtim me nenin 193 (1) dhe (2) të KPPK-së;

duke vepruar në pajtim me Urdhrin PN1 Nr. 2002/17 të lëshuar me datën 20 tetor 2017 nga Gjyqtarja kryesuese dhe raportuese në rastin me numër PAKR 1/2017 para Gjykatës së apelit që i pandehuri **E.S.** to arrestohet menjëherë, që masa e arrestit shtëpiak të zëvendësohet me masën e

paraburgimit, dhe që seanca për caktimin e masës së paraburgimit të mbahet me datën 24 tetor 2017;

pas mbajtjes së seancës dëgjimore me datën 24 tetor 2017 dhe pas shqyrtimit të Kërkesës së prokurorit special me datën 20 tetor 2017, letrës nga **A.H.**, dokumenteve të paraqitura nga prokurori special gjatë seancës dëgjimore si dhe Propozimit me shkrim të paraqitur nga avokatja mbrojtëse **K.K.** me datën 25 tetor 2017;

në pajtim me nenet 183 paragrafët 3, 4 5 dhe 6 dhe neni 187 paragrafi 1 pikat 1.2.1, dhe neni 193 paragrafi 2 të KPP-së;

lëshon si në vijim:

AKTVENDIM

Për caktimin e masës së paraburgimit kundër të pandehurit E.S., tashmë i arrestuar sipas Urdhrit të kësaj gjykate të datës 20 tetor 2017. Paraburgimi mund të shqyrtohet në pajtim me nenin 193 paragrafi 2 të KPP-së nga Gjykata e shkallës së parë ku rasti dërgohet për rigjykim.

ARSYETIM

I. Historiku procedural

1. Me datën 24 prill 2014 Prokurori i PSRK-së ngriti aktakuzën PPS nr. 467/2009 ku i pandehuri ishte ngarkuar me tri vepra penale Shtytje për kryerjen e vrasjes së rëndë, Detyrim dhe Dhunim.
2. Seanca dëgjimore fillestare u mbajt me datën 30 prill 2014. Kryetari i trupit gjykues, me Aktvendimin e datës 12 qershor 2014, e refuzoi si të pabazuar Kërkesën e avokatit mbrojtës në emër të të pandehurit **E.S.**, për refuzimin e Aktakuzës dhe për të shpallur provat si të papranueshme. Ky Aktvendim është ankimuar nga avokati mbrojtës në emër të **E.S.**, e cila ankesë është refuzuar si e pabazuar me Aktvendimin e Gjykatës së apelit të datës 07 gusht 2014.
3. Seancat kryesore të shqyrtimit u mbajtën më 31 tetor 2014; 5, 6 10, 14, 19, 20, 21 nëntor 2014; 16 dhjetor 2014; 10, 13, 14, 22, 27, 28, 29 janar 2015; 11 dhe 12 shkurt 2015; 4 dhe 31 mars 2015; 27 dhe 30 prill 2015; 25, 28 dhe 29 maj 2015; 1, 2, 3, 15,

- 26 qershor 2015; 20, 21, 22 dhe 23 korrik 2015; 17, 18, 19, 20 dhe 21 gusht 2015; 1, 2, 5, 6, 29 dhe 30 tetor 2015; 2, 3, 4, 5, 6, 17, 18 dhe 30 nëntor 2015; 1, 2, 3 dhe 4 dhjetor 2015; 25 janar 2016; 2, 3, 7, 8 dhe 9 mars 2016; 12, 13, 14, 19 2016. Aktakuza e ndryshuar është ngritur më 27 prill 2016, duke marrë parasysh minutazhet e korrigjuara të SMS-ve. Shqyrtimi kryesor vazhdoi më 29 prill 2016 dhe 12 maj 2016.
4. Në pajtim me nenin 541 të KPP-së i cili hyri në fuqi me datën 01 janar 2013, gjykimi u zhvillua sipas dispozitave të Kodit të ri të procedurës penale derisa në lidhje me veprat penale gjykata e shkallës së parë konstatoi se Kodi i vjetër penal ishte më i favorshëm për këtë të pandehur. Aktgjykimi i Gjykatës themelore të Prishtinës u shpall në publik me datën 17 maj 2016. Avokati mbrojtës në emër të pandehurit paraqiti Ankesë kundër Aktgjykimit.
 5. Seanca publike para Kolegjit të Gjykatës së apelit u mbajt me datën 06 shtator 2017. Kolegji u këshillua dhe votoi me datën 07 shtator 2017 dhe me datën 19 tetor 2017. Aktgjykimi i Gjykatës së apelit aktualisht është në procesin e hartimit.
 6. Me datën 02 tetor 2017 avokatja mbrojtëse K.K dhe avokati mbrojtës B.P paraqiten Propozimin në emër të të pandehurit E.S., dhe i propozoi Gjykatës së apelit heqjen e masës së paraburgimit.
 7. Me datën 19 tetor 2017 kolegji lëshoi një Vendim për pranimin e Propozimit dhe hoqi masën e paraburgimit dhe e zëvendësoi atë me masën e arrestit shtëpiak. Kolegji më tej e udhëzoi të pandehurin që të mos largohej nga vendbanimi dhe të mos takoj persona me të cilët nuk jeton. Urdhri gjithashtu theksoi se aktvendimi i arsyetuar i Gjykatës së apelit për arsyet e heqjes së masës së paraburgimit do të lëshohej me kohë dhe do t'iu dërgohej të gjitha palëve. Një Aktvendim i tillë nuk u lëshua pasi u pushtua nga ngjarjet duke u kthyer në një aktvendim të vjetruar. I pandehuri ka shkelur masën të njëjtën ditë dhe:
 8. Me datën 20 tetor 2017, duke vepruar sipas Kërkesës së prokurorit special të EULEX-it, ku përfshihej edhe raporti i policisë lidhur me pretendimet për shkeljen e kushteve të masës së arrestit shtëpiak, gjyqtarja kryesues lëshoi Urdhër që I pandehuri të arrestohej menjëherë, që masa e arrestit shtëpiak e urdhëruar me datën 19 tetor 2017 të zëvendësohet me masën e paraburgimit në Burgun e sigurisë së lartë në Gërdovc, dhe që seanca për caktimin e paraburgimit të mbahet me datën 24 tetor 2017. Shkelja e pretenduar ishte se 2 persona me të cilët i pandehuri nuk jetonte : A.H. dhe L.Rr kishin vizituar të pandehurin në shtëpinë e tij në mbrëmjen e datës 19 tetor 2017 dhe se L.Rr kishte postuar në Facebook në ora 21:51minuta një fotografi të 2 prej tyre së

bashku me të pandehurin. I pandehuri u arrestua dhe u dërgua në Burgun e sigurisë së lartë të nesërmen në mëngjes.

9. Me datën 21 tetor 2017 gjyqtari kryesues pranoi një letër nga A.H., ku ai sqaronte rrethanat në të cilat ai dhe L.Rr. vizuan **E.S.**
10. Seanca për caktimin e paraburgimit u mbajt me datën 24 tetor 2017 në ora 14.00minuta, kur i pandehuri ishte sjellë para Gjyqtarit kryesues. Gjatë kësaj seance gjyqtari kryesues pranoi nga Prokuroria speciale 3 letra anonime të cilat ishin dërguar në Prokurorinë speciale dhe të cilat pretendonin aktivitetin kriminal nga i pandehuri **E.S** dhe të tjerët. Gjyqtari kryesues po ashtu pranoi nga Prokurori special një raport të shtypur në xxx të datës 19 tetor 2017 me kohën 23.56minuta, ku përfshihen 2 fotografi të të pandehurit me një person tjetër të cilat sipas xxx ishin bërë në shtëpinë e tij pasi ishte liruar nga burgu. Prokurori special tha po ashtu se derisa po mbahej seanca dëgjimore, Prokuroria kishte marrë një intervistë nga B.H dhe i cili pretendonte se kishte dëgjuar bisedën midis të pandehurit dhe një personi tjetër në burgun e Sigurisë së lartë pas kthimit të të pandehurit me datën 21 tetor, dhe ku i pandehuri kishte diskutuar planet e tij për të ikur por që nuk kishte pasur kohë të mjaftueshme. Kopjet e këtyre dokumenteve iu dhanë avokates mbrojtëse K.K. menjëherë pas seancës dëgjimore. Gjyqtari kryesues ishte drejtuar avokates mbrojtëse se afati i fundit për të që të paraqesë ndonjë përgjigje ndaj këtyre dokumenteve ishte mëngjesi i së enjtes të datës 26 tetor 2017 (ora 12:00 minuta). Një propozim ishte paraqitur nga avokatja mbrojtëse K.K. me datën 25 tetor 2017, dhe iu dorëzua Prokurorit special.

II. Parashtrësat e palëve

11. Prokurori special.

Gjatë seancës, Prokurori special ia kujtoi gjyqtarit kryesues Kërkesën të cilën ai e kishte paraqitur me datën 20 tetor 2017, në të cilën ai pohoi se sjellja e të pandehurit menjëherë pas lirimit të tij nga paraburgimi tregon mungesën e respektit të të pandehurit ndaj Aktvendimit të kolegjit dhe sugjeron se mund të priten edhe shkelje të mëtejme. Më tutje, kjo shpi tek supozimi i vërtetë se i pandehuri nuk do të përmbahet nga largimi nga shtëpia ose nga kontaktimi me persona të tjerë. Prokurori special parashtrëtoi Urdhri sipas të cilit ai u lirua në arrest shtëpiak është shkruar në një gjuhë shumë të thjeshtë dhe të qartë, e cila nuk lë hapësirë për keqkuptime lidhur me nevojën e lejes së gjyqtarit kryesues për të pranuar vizita. Derisa A.H. është avokat për të pandehurin në një rast tjetër, vizita e tij nuk është përjashtim dhe duhet të jetë dhënë leja nga gjyqtari kryesues. L.Rr. nuk ka lidhje familjare me të pandehurin. Më

tej, prokurori special tani ka informata nëse këto nuk ishin vizitat e vetme që i pranoi i pandehuri atë natë dhe se fotografitë e njerëzve të tjerë u shfaqën në faqen e internetit të xxx.

12. Prokurori special deklaroi që Gjykata së shpejti do të pranoj një raport policor lidhur me një bisedë të dyshuar në mes të pandehurit dhe një personi tjetër në Burgun e sigurisë së lartë me datën 21 tetor 2017 gjatë së cilës i pandehuri kishte diskutuar planin e tij për të iku. Prokurori special parashtrroi se dyshimi i bazuar vazhdon të ekzistojë sepse, deri më tani, ende qëndron dënimi i tij sipas Aktgjykimit të Gjykatës së qarkut. Prandaj ekziston një rrezik real i ikjes. Prokurori special gjithashtu ia kujtoi gjyqtarit kryesues se i pandehuri ishte larguar nga vendi në të kaluarën dhe se ishte i nevojshëm një letër rreshtim ndërkombëtar për ta bindur të pandehurin që të dorëzohej. Sjellja e tij tregon një mosrespektim të plotë ndaj Urdhrit të gjyqtarit kryesues dhe paaftësinë e tij për t'iu bindur urdhrave të thjeshta gjyqësore. Prokurori special pohoi se i pandehuri është një kriminel i profilit të lartë dhe udhëheqësi i një grupi kriminal i cili ka prirje të kryej veprime të dhunshme dhe frikësime. Për më tepër ka shqetësime se aktiviteti kriminal është ende vazhdon. Ai përfundoi se të gjitha këto arsye e bëjnë arrestimin shtëpiak absolutisht të papërshtatshëm për të mbrojtur rendin publik dhe përse ai ka kërkuar nga gjyqtari të ta kthej atë nën masën e paraburgimit.

13. Avokatja mbrojtëse K.K.

Gjatë seancës dëgjimore, avokatja mbrojtëse deklaroi se me datën 19 tetor 2017 pas orës 17.00 minuta ajo pranoi një telefonatë nga një zyrtar i EULEX-it i cili e njoftoi atë se masa e paraburgimit kundër të pandehurit është zëvendësuar me masën e arrestit shtëpiak dhe Urdhri tashmë ishte dërguar në burg dhe se ajo do të pranonte kopjen e këtij Urdhri të nesërmen. Avokatja mbrojtëse deklaroi se ajo telefonoi familjen e të pandehurit lidhur me këtë njoftim. Gjatë kësaj kohe, papritur i pandehuri u informua nga personeli i burgut se paraburgimi i tij ishte duke u zëvendësuar me arrest shtëpiak dhe se ai duhej përgatitur për të shkuar në shtëpi. I pandehuri nxitoi të mbledhë gjësendet e tij personale, përfshirë këtu njoftimin e dhënë nga gardianët dhe dosjen e rastit. Ai nuk e lexoi Urdhrin. Kur arriti në shtëpi, shtëpia e tij ishte e mbushur me njerëz - familjarë, miq dhe fqinjë. Asnjëri prej tyre nuk ishte në dinte se çfarë përmbante Urdhri. I pandehuri nuk kishte çfarë të bënte kur gjeti përafërsisht 100 vetë në shtëpinë e tij kur mbërriti atje. Avokatja mbrojtëse deklaroi se në orën 08.30 minuta të mëngjesit ajo pranoi Urdhrin. Ajo menjëherë e kontaktoi të pandehurin por tashmë ishte tepër vonë. Sikur ajo ta dinte gjithë përmbajtjen e Urdhrit ajo do ta informonte familjen S. dhe do t'i udhëzonte ata se askush nuk duhet të vizitojë shtëpinë. Kur ajo ia tha familjes, ata mbyllën dyert e shtëpisë së tyre dhe

nuk pranuan askënd tjetër. Avokatja mbrojtëse deklaroi se nuk ka kuptim që i pandehuri, pas viteve të kaluara duke u fshehur dhe në paraburgim, ta shkelë qëllimisht Urdhrin dhe do të humb mundësinë që të qenë në arrest shtëpiak. Ajo deklaroi se masa e arrestit shtëpiak ishte caktuar për të siguruar praninë e të pandehurit, ndërkohë që kufizimi shtesë për të mos kontaktuar të tjerët ka për qëllim që të shmangë kontaktin në mes të pandehurit dhe dëshmitarëve të mundshëm ose të tjerëve që mund të lidhen me rastin e tij. Njerëzit që shkuan në shtëpinë e tij nuk janë të asaj cilësie. Për më tepër, masa kryesore e arrestit shtëpiak nuk është shkëlur. Ajo thotë se nëse atij i jepet një tjetër mundësi nuk do të ketë më neglizhencë apo gabim më të vogël dhe se nuk kishte pasur asnjë qëllim të mos respektimit të Urdhrit.

14. Avokatja mbrojtëse deklaroi se lidhur me raportin e B.H., ai ndodhet në katin e tretë të burgut dhe megjithatë ai arrin të dëgjojë bisedën e të pandehurit në katin përdhese. Ai nuk e informon stafin e burgut por personalisht telefoni rreshterin M. K. i cili ndodh të jetë dëshmitar në këtë gjyq. Avokatja mbrojtëse parashtron se raporti i B.H. është një fabrikim. Lidhur me 3 letrat anonime, avokatja mbrojtëse thekson se edhe pse ajo nuk është një grafologe, ata kanë të njëjtën shkrim dhe ata e dinë saktësisht se kujt duhet ti drejtohen. Në fund, avokatja mbrojtëse përsëriti kërkim faljen në emër të të pandehurit dhe deklaroi se nëse i jepet një mundësi tjetër ajo të jetë e gatshme të specifikojë xxx anëtarët e familjes së tij me të cilët jeton dhe se askush tjetër përveç tyre nuk do të takohet me të pandehurin pa lejen e gjykatës. Për më tepër, ai nuk ka dokument të vlefshëm udhëtimi ose letërnjoftim, dhe ai i fundit ka skaduar në vitin 2012 derisa ai gjendej në paraburgim.
15. Gjyqtarja kryesuese pyeti të pandehurin nëse atij i ishte dorëzuar Urdhri dhe ia për kujtoi atij se nuk duhej të përgjigjej. I pandehuri deklaroi se atij i ishte dhënë Urdhri dhe i tha se ishte nën arrest shtëpiak, por asgjë më tepër. Ai deklaroi se ai e vendosi dokumentin me dokumentet e tjera në mënyrë që të mos i humbiste ato. Ai nuk e lexoi atë dhe ai nuk kishte kohë ta lexonte. Kur arriti në shtëpi aty kishin ardhur shumë miq por edhe sikur të mos ishin ata, ai nuk do ta kishte lexuar atë dhe do të kishte pritur që mbrojtësi i tij t'ia shpjegonte atë.
16. Prokurori special pyeti se si ndodh që i pandehuri ishte në posedim të një pasaporte pasi që Gjykata kishte lëshuar një Urdhër që konfiskoi të gjitha dokumentet e udhëtimit. Avokatja mbrojtëse u përgjigj se pasaporta ishte në posedim të prokurorit Andrew Carney i cili e ktheu atë dhe pasaporta ka qenë në dosjen e rastit që atëherë.

Propozimi me shkrim i avokates mbrojtëse

17. Në Propozimin e saj me shkrim, avokatja mbrojtëse K.K. kundërshton raportin e xxx M.K... Ajo pohon se ky oficer policor ishte dëshmitar i prokurorisë në gjykimin e shkallës së parë të të pandehurit dhe se ai po vazhdon me veprimet e tij hetimore. Është e dyshimtë se si ndodhi që ky dëshmitar të dëgjonte bisedën e të pandehurit, dhe gjithashtu ndodhi që të ishte në posedim të numrit të telefonit personal të oficerit policor M.K. Për mbrojtjen është e qartë se kjo është një dëshmi e rrejshme. B.H. është dënuar për vepra shumë të rënda penale dhe është dënuar me xxx vjet burgim dhe është po i njëjti dëshmitar i cili gjithashtu ka denoncuar në mënyrë të rrejshme një gjyqtar të xxx dhe 2 avokatë mbrojtës dhe ka mashtruar një prokuror të xxx. B.H nuk ka asgjë për të humbur dhe është i njëjti person që u përpoq ta vrasë të pandehurin në një incident xxx ku u vranë 2 persona dhe u plagosën 11 të tjerë. Është qesharake të besohet se ai dëgjoi një bisedë nga një dritare gjysmë e hapur nga kati i tretë që po ndodhte në qelinë e të pandehurit. Është gjithashtu qesharake se i pandehuri do të diskutonte planin e tij për të ikur, me një të huaj, me zë të lartë që të dëgjohej në atë distancë. Më tej, në intervistë B.H. deklaroi se ai ka bërë një ankesë tek drejtori kujdestar F.H. rreth zhurmës, por jo për atë që kishte dëgjuar. Në vend të kësaj, të nesërmen ai bëri një raport për xxx M.K..

Avokatja mbrojtëse gjithashtu thekson se xxx M.K. nuk e intervistoi personin i cili thuhet se kishte biseduar me të pandehurin lidhur me planin e tij për të ikur, nuk e intervistoi xxx F.H. e as nuk hetoi nëse dikush tjetër e kishte dëgjuar bisedën. Lidhur me 3 letrat anonime, ato kanë përmbajtje absolutisht identike dhe shkrimi është i njëjtë, dhe të tre janë dërguar të njëjtit Prokuror të apelit në të njëjtën ditë me datën 07 shtator 2017. Për më shumë, njëra nga këto letra ishte në anglisht dhe pastaj u përkthye në shqip, 2 ditë më vonë. Kjo do të thotë se ishte në gjuhën angleze para se ta shkruante me dorën e tij në gjuhën e tij amtare shqipe. Avokatja mbrojtëse propozon që Gjykata të lëshon një Aktvendim duke zëvendësuar paraburgimin e të pandehurit me arrest shtëpiak.

III. Gjetjet e Gjykatës së apelit

18. Gjyqtarja kryesuese thekson se avokates mbrojtëse K.K. i ishte dorëzuar një kopje e Urdhrit i cili e liroi të pandehurin nga paraburgimi për të mbajtur arrestin shtëpiak në mëngjesin e së premtes me datën 20 tetor 2017. Është pranuar që në mbrëmjen e datës 19 tetor 2017 ajo u njoftua verbalisht përmes thirrjes telefonike nga një anëtar i personelit të gjykatës se i pandehuri ishte vendosur në arrest shtëpiak sipas Urdhrit.

19. Çështja është nëse po apo jo, dhe kur të pandehurit i është dhënë një kopje e Urdhrit. Siç është theksuar nga Prokurori special, një oficer policor i stacionit policor Veri ka paraqitur një 'Raport policor' të datës 19 tetor 2017 dhe ka kohën 19.15minuta. Ky raport deklaroi se pas pranimit të Urdhrit afërsisht në orën 17.00minuta është marrë udhëzimi për të shkuar në Burgun e sigurisë së lartë dhe për të përcjellë të pandehurin **E.S.** nga atje tek shtëpia e tij. Si rezultat, 3 policë shkuan në burg, e morën të pandehurin dhe pastaj e dërguan atë në shtëpinë e tij. Raporti më tej thekson se oficerët policor ia dhanë atij Vendimin e Gjykatës dhe gjithashtu verbalisht i treguan atij se si të vepronte lidhur me të. Gjatë seancës dëgjimore, avokatja mbrojtëse deklaroi se të pandehurit i ishte dhënë Urdhri në Burgun e sigurisë së lartë. Vetë i pandehuri deklaroi se atij i ishte dhënë një kopje e Urdhrit, por që ai nuk e lexoi atë.
20. Urdhri për lirim të pandehurit ishte një dokument i shkurtër. Kufizimet që shoqërojnë masën e arrestit shtëpiak, ato lidhur me përmbajtjen nga kontaktimi i personave me të cilët ai nuk jeton dhe mos largimi nga vendbanimi janë shkruar në gjuhë të thjeshtë dhe të qartë, në mënyrë që ato të mund të kuptohen lehtësisht nga një person laik. Shkelja e kufizimeve të arrestit shtëpiak nuk mund të shfaqësohet nga mos leximi i Urdhrit nga ana e të pandehurit, i cili pa dyshim që ishte një dokument jashtëzakonisht i rëndësishëm. Urdhri gjithashtu informon të pandehurin, përsëri në gjuhë të thjeshtë lidhur me pasojat e mospajtimit në përputhje me nenin 183 paragrafi 5. Kufizimet që shoqëruan masën e arrestit shtëpiak ishin vendosur për shkak të seriozitetit maksimal, në mënyrë që shkelja e tyre të mos mund të pasohet nga një mundësi e dytë për t'u pajtuar me to. Prandaj, Gjykata konstaton se është e përshtatshme që sërish të caktohet masa e paraburgimit kundër të pandehurit.
21. Në pajtim me nenin 187 paragrafi 1 pika 1.1 të KPP-së, Gjykata mund të caktoj masën e paraburgimit vetëm pasi të konstatohet në mënyrë eksplicite se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer një vepër penale. Rezultati i ankesës së paraqitur nga i pandehuri kundër Aktgjykimit të Gjykatës themelore Pkr nr. 218/14 të datës 17 maj 2016 është se rasti kundër të pandehurit është kthyer në rigjykim. Arsyetimi për këtë vendim është paraqitur plotësisht në Aktgjykimin e Gjykatës së apelit. Megjithatë, Gjykata gjen se dyshimi i bazuar vazhdon të ekzistojë lidhur me shoqërimin e të pandehurit me vrasjen e të ndjerit T.R. si dhe se shkelja procedurale e gjetur nga Gjykata e apelit në Aktgjykimin e Gjykatës themelore nuk do të thotë ndryshe.
22. Sa i përket kushtit apo kushteve të parapara në nenin 187 paragrafi 1 pika 1.2 të KPP-së, të cilat gjithashtu duhet të përmbushen për të urdhëruar paraburgimin, Gjykata konstaton se ekziston rreziku i ikjes. Është sjellë nder mend se i pandehuri u largua nga juridiksioni dhe ishte fshehur për një kohë dhe se ishte lëshuar një letër

rreshtim ndërkombëtar. I pandehuri vazhdon të përballlet me veprën më të rëndë penale, për të cilën ka të ngjarë të dënohet me një dënim të rëndë me burg nëse dënohet. Këto rrethana paraqesin një motivim substancial për të pandehurin që të ikën. Prandaj Gjykata gjen se kushti sipas nenit 187 paragrafi 1 pika 1.2 është plotësuar dhe se asnjë masë tjetër më e butë nuk mjafton për të përballuar rrezikun. Duke deklaruar kështu Gjykata nuk i jep peshë deklaratës së dëshmitarit të dhënë nga B.H. në polici. Dëshmitari nuk është dëgjuar nga Gjykata në mënyrë që deklarata e tij të mund të vlerësohet siç duhet dhe se përndryshe kjo deklaratë është një dokument i ngutshëm të cilës i mungojnë detajet. Gjykata konstaton se nuk është e nevojshme të vlerësohet më tej deklarata, pasi kushti i paraparë sipas nenit 187 paragrafi 1 pika 1.2 është përmbushur tashmë nga ekzistimi i rrethanave tjera, siç është detajuar më lart.

23. Pasi që rasti është kthyer në rigjykim, masa e paraburgimit do të caktohet në pajtim me nenin 193 (2) KPPK.

Përgatitur në gjuhën angleze, si gjuhë e autorizuar me datën 26 tetor 2017

Procesmbajtëse

Gjyqtarja kryesuese

Kerry Moyes
Zyrtar ligjor

Elka Filcheva-Ermenkova
Gjyqtare e EULEX-it